

Vendim nr. 120 datë 06.06.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 06.06.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 4 (I) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ILIRJAN KAVAJA, MERSIN DISHA, BARDHYL DERVISHI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-3448, datë 10.11.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Shtetasit Ilirjan Kavaja, Mersin Disha dhe Bardhyl Dervishi (*kërkuesit*) kanë banuar në banesat nr. 420, 421, 422 në qytetin e Durrësit, të cilat kanë qenë të paprivatizuara. Në prill të vitit 1994, Bashkësia Islamike Durrës (Komuniteti Mysliman Shqiptar, Dega Durrës) i është drejtuar Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP), Durrës me kërkesë për njohjen e pronësisë dhe kthimin e pronave që përbëhen nga banesat nr. 420, 421, 422 etj. me vendndodhje në Durrës. Lidhur me këtë kërkesë është plotësuar dosja përkatëse nr. 954, datë 06.04.1994, ku, ndër të tjera, është përfshirë edhe vendimi nr. 1838, datë 19.10.1993 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (vërtetim fakti juridik), që ka përcaktuar vendndodhjen, kufizimet dhe përbërjen e pronës së pretenduar.

2. KKKP-ja, Durrës, me vendimin nr. 1331, datë 20.04.1996, ka njohur pronësinë dhe i ka kthyer Bashkësisë Islamike Durrës, midis të tjerash, edhe banesat nr. 420, 421 dhe 422 në Durrës. Duke qenë se çështja lidhet me disa procese gjyqësore, Kolegji vlerëson t'i parashtrojë ato të ndara.

Procesi i parë gjyqësor

3. Banorët e banesave nr. 420, 421 dhe 422, përkatësisht shtetasit M. D., B. Sh., G. I., Ilirjan Kavaja, Sh. J., Bardhyl Dervishi dhe N.A. kanë paraqitur kërkesëpadi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me objekt anulimin e vendimit të KKKP-së, Durrës dhe detyrimin e Entit të Banesave që të privatizojë banesat, me palë të paditura Komunitetin Mysliman Shqiptar, Dega Durrës, Entin e Banesave Durrës dhe KKKP-në, Durrës. Padia e tyre është ngritur mbi pretendimet se: (i) këto banesa janë ndërtuar gjatë viteve 1935-1942 nga një shoqëri italiane dhe më pas kanë qenë pronë e Bashkisë Durrës; (ii) pas çlirimit, banesat kanë qenë pronë e shtetit shqiptar; (iii) vendndodhja dhe kufizimet e banesave që iu kthyen Bashkësisë Islamike Durrës me vendimin nr. 1331, datë 20.04.1996 të KKKP-së, Durrës janë përcaktuar me vendimin nr. 1838, datë 19.10.1993 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës (vërtetim fakti juridik). Ky fakt bën që vendimi i KKKP-së, Durrës është dhënë në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr.7698 datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”, të ndryshuar (*ligji nr. 7698/1993*), ku përcaktohet në mënyrë taksative se njohja e pronësisë duhet bërë me palë kundërshtare.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 618, datë 18.06.1999, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, me arsyetimin se paditësit nuk kanë provuar se këto banesa janë ndërtuar nga shoqëria italiane “K.” në vitet 1935-1942, ndërkohë që Komuniteti Mysliman Shqiptar, Dega

Durrës ka paraqitur edhe disa prova të tjera në mbështetje të vendimit të KKKP-së, Durrës. Ky vendim është kundërshtuar nga paditësit.

5. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 509, datë 27.09.1999, ka lënë në fuqi vendimin nr. 618, datë 18.06.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Ky vendim ka marrë formë të prerë dhe paditësit nuk kanë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Procesi i dytë gjyqësor

6. Në datën 01.12.2000, shtetasit M.D., B.Sh., G.I., Ilirjan Kavaja, Sh.J., Bardhyl Dervishi dhe N.A. kanë kërkuar rishikimin e vendimit nr. 618, datë 18.06.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Me vendimin e ndërmjetëm të datës 08.01.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është pranuar kërkesa për rishikimin e vendimit dhe çështja është kaluar në seancë për vazhdimin e gjykimit. Ky vendim është ankimuar nga Komuniteti Mysliman Durrës në Gjykatën e Apelit Durrës.

7. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 61, datë 26.04.2001, ka ndryshuar vendimin e ndërmjetëm të datës 08.01.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe ka rrëzuar kërkesën për rishikimin e vendimit nr. 618, datë 18.06.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me arsyetimin se pretendimet e paditësve janë analizuar nga gjykata e rrethit dhe ajo e apelit kur është marrë vendimi, për të cilin kërkohet rishikimi. Provat e paraqitura nga paditësit nuk përbëjnë as provë, as rrethanë të re. Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs nga ana e paditësve.

8. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 494, datë 03.05.2002, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur.

Procesi i tretë gjyqësor

9. Me kërkesëpadinë e datës 24.05.2006 dhe ndërhyrjen kryesore të datës 20.08.2006, palët M.B., Ilirian Kavaja, Mersin Disha, H.I., Bardhyl Dervishi dhe Sh. J. kanë kërkuar pavlefshmërinë e vendimit nr.1331, datë 20.04.1996 të KKKP-së, Durrës dhe detyrimin e Bashkisë Durrës që të privatizojë banesat. Palë të paditura në këtë proces ishin Komuniteti Mysliman Shqiptar, Dega Durrës, Bashkia Durrës dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP) Durrës.

10. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 393, datë 08.02.2008, ka vendosur pranimin e padisë së paditësve dhe të ndërhyrësve kryesorë, konstatimin si absolutisht të pavlefshëm të vendimit nr.1331, datë 20.04.1996 të KKKP-së, Durrës për banesat 420, 421 dhe

422, si dhe detyrimin e Bashkisë Durrës të bëjë privatizimin e këtyre banesave në favor të tyre. Kjo gjykatë ka arsyetuar se vendimi nr. 1331, datë 20.04.1996 i KKKP-së, Durrës, me të cilin i është njohur e kthyer pronësia palës së paditur, Komunitetit Mysliman Shqiptar, Dega Durrës, është absolutisht i pavlefshëm, pasi ky vendim bie në kundërshtim me ligjin nr. 7698, datë 15.04.1993 dhe udhëzimin nr. 3 të Këshillit të Ministrave.

11. Vendimi i mësipërm është ankimuar nga palët e paditura në këtë proces dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2010-309 (159), datë 07.04.2010, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 393, datë 08.02.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe kthimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues, pasi procesverbali i seancës gjyqësore të datës 04.02.2008 nuk ishte firmosur nga kryesuesi i seancës, si dhe vendimi i dhënë ishte nënshkruar vetëm nga një gjyqtar, ndërkohë që dy anëtarët e tjerë të trupit gjykues nuk e kanë firmosur vendimin.

12. Në procesin e rigjykimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2011-2295) 1180, datë 03.05.2011 ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së paditësve Bardhyl Dervishi etj. e të ndërhyrësve kryesorë Sh. J. etj., si dhe konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 1331, datë 20.04.1996 të KKKP-së, Durrës. Për kërkimet e tjera gjykata ka rrëzuar kërkesëpadinë si të pambështetur në prova e në ligj. Kundër këtij vendimi, në datën 18.05.2011, Komuniteti Mysliman Shqiptar, Dega Durrës ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Durrës.

13. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2014-82/41, datë 16.01.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. (11-2011-2295) 1180, datë 03.05.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke rrëzuar padinë e kërkuësve, me arsyetimin se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë duke zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin, pasi çështja e ngritur nga paditësit dhe ndërhyrësit kryesorë përbën gjë të gjykuar, si me anë të një gjykimi themeli, ashtu edhe gjatë një procesi rigjykimi të çështjes. Vendimi nr. 1331, datë 20.04.1996 i KKKP-së, Durrës është gjetur i drejtë dhe i ligjshëm ndaj pretendimeve të palës paditëse dhe ndërhyrësve kryesorë në gjykimet e mëparshme. Kundër këtij vendimi, në datën 14.02.2014, pala paditëse M.B., Ilirian Kavaja e Mersin Disha dhe ndërhyrësja kryesore H.I. kanë ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë. Komuniteti Mysliman Shqiptar ka paraqitur kundërekurs.

14. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-3448, datë 10.11.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit të palës paditëse dhe ndërhyrësve kryesorë kundër vendimit nr.

10-2014-82/41, datë 16.01.2014 të Gjykatës së Apelit Durrës. Ky Kolegj e ka vlerësuar si të bazuar në ligj përfundimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, se vendimi nr.1331, datë 20.04.1996 i KKKP-së, Durrës është gjetur i drejtë dhe i ligjshëm, ndaj pretendimeve të palës paditëse dhe ndërhyrësve kryesorë në gjykimet e mëparshme. Ky kolegj ka arsyetuar se objekti i kërtimeve është i njëjtë, pasi kërkesëpadia në kuptimin formal-procedural ka pasur ndryshim vetëm në formulim, hartim ose ndërtim të fjalisë, ndërsa padia në kuptimin material-substancial është e njëjtë në të dyja rastet.

15. Kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykatës*) në datën 29.03.2023, me ankim kushtetues për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-3448, datë 10.11.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

II

Pretendimet e kërkuësve

16. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se vendimi gjyqësor i kundërshtuar u ka cenuar të *drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

- 16.1. *Së drejtës së njoftimit*, pasi vendimi i ndërmjetëm i datës 25.10.2022 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk u është njoftuar kërkuësve Bardhyl Dervishi dhe Mersin Disha, duke passjellë zhvillimin e një procesi të parregullt ligjor.
- 16.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, nëpërmjet vendimit të ndërmjetëm të datës 25.10.2022, ka revokuar vendimin e datës 28.07.2017 të kolegjit paraardhës që kishte vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, duke u mbështetur në ndryshimet që i janë bërë disa dispozitave të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*) në vitin 2021 dhe duke i dhënë fuqi prapavepruese këtyre ndryshimeve, ndërkohë që nuk argumenton shkaqet dhe arsyet ligjore të këtij revokimi.
- 16.3. *Parimit të sigurisë juridike*, pasi në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është mbajtur i njëjti qëndrim sikurse në vendimin e gjykatës së apelit, se në rastin konkret gjen zbatim parimi i gjësë së gjykuar. Një konstatim i tillë bie ndesh me nenin 451/a të KPC-së, pasi në vendimin nr. 618, datë 18.06.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, objekt gjykimi ka qenë anulimi i vendimit nr. 1331, datë 20.04.1996 të KKKP-

së, Durrës, ndërsa në vendimin nr. (11-2011-2295) 1180, datë 03.05.2011, të po kësaj gjykate, objekti i gjykimit ka qenë konstatimi i pavlefshmërisë absolute të vendimit të sipërcituar. Po kështu, edhe të paditurit nuk kanë qenë të njëjtët në këto gjykime.

16.4. *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka zhvilluar asnjë seancë gjyqësore për rekursin e depozituar nga kërkuesit për një periudhë prej 5 vjetësh e 3 muajsh, përkatësisht nga viti 2017 deri në datën 25.10.2022.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

17. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

18. Ankimi kushtetues, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesit të mos legjitimohen për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

19. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Kolegji vlerëson se kërkuesit legjitimohen *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit kanë ngritur pretendime në ankimin kushtetues, e për rrjedhojë kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

20. Një kriter tjetër paraprak që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000 ka të bëjë me *shterimin e mjeteve juridike efektive*. Për plotësimin e këtij kriteri kërkuesit duhet të

shfrytëzojnë në rrugë normale mjetet juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesit, të cilët para se t'i drejtohen Gjykatës duhet të vërtetojnë se kanë përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, duhet theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike efektive, në kuptimin e shterimit të atyre mjeteve që janë të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 38, datë 02.12.2021; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t'u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t'i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimin nr. 15, datë 07.05.2018 të Gjykatës Kushtetuese*). Prandaj, shkelja e të drejtave kushtetuese mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pas shterimit të të gjitha mundësive që ofron sistemi i padive dhe i apelimeve (*shih vendimet nr. 45, datë 01.11.2013; nr. 10, datë 09.05.2005; nr.10, datë 02.04.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesit kanë pretenduar, midis të tjerash, cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka zhvilluar asnjë seancë gjyqësore për rekursin e depozituar nga ana e tyre për një periudhë prej 5 vjetësh e 3 muajsh, përkatësisht nga viti 2017 e deri në datën 25.10.2022.

23. Në këndvështrim të sa më sipër, Kolegji konstaton se këtë pretendim kërkuesit e kanë parashtruar drejtpërdrejt përpara tij, duke mos shteruar paraprakisht mjetet juridike efektive që kanë pasur në dispozicion sipas neneve 399/1 – 399/12 të KPC-së. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se, si rregull, shqyrtimi i këtyre lloj çështjesh dhe vlerësimi përfundimtar në lidhje me kohëzgjatjen e arsyeshme të gjykimit duhet të bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja, në përputhje me parimin e subsidiaritetit (*shih vendimet nr. 3, datë 17.02.2022; nr. 2, datë 17.02.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin në shqyrtim, kërkuesit nuk i kanë përdorur këto mjete ligjore të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së, për të mbrojtur të drejtën kushtetuese të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ndaj ky pretendim i tyre nuk

mund të merret në shqyrtim, pasi ata nuk kanë shteruar mjetet juridike efektive që kanë pasur në dispozicion.

24. Kolegji vëren, gjithashtu, se dy prej kërkuessve, Bardhyl Dervishi dhe Mersin Disha, kanë pretenduar se vendimi i ndërmjetëm i datës 25.10.2022 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk u është njoftuar, duke passjellë zhvillimin e një procesi të parregullt ligjor nga kjo gjykatë. Kërkuessit i kanë bashkëlidhur ankimit vendimin e revokimit të datës 25.10.2022, në dispozitivin e të cilit Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur revokimin e vendimit për shqyrtimin e çështjes civile nr. 11243-01124-00-2014 të regjistrimit themeltar në seancë gjyqësore dhe kthimin e çështjes për shqyrtim në dhomë këshillimi mbi bazë të dokumenteve në datën 10.11.2022. Po kështu, ata kanë pretenduar se vendimi i ndërmjetëm nuk është arsyetuar.

25. Kolegji konstaton se në zbatim të dispozitave të reja ligjore, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka revokuar vendimin e datës 28.07.2017 për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, duke vendosur gjykimin e saj në dhomë këshillimi, çka është arsyetuar edhe në vendimin e tij. Ky kolegji ka vlerësuar se çështja e kërkuessve ishte e tillë që mund të gjykohej në dhomë këshillimi pa praninë e palëve, mbi bazë të dokumenteve.

26. Për sa i përket kësaj vendimmarrjeje të Gjykatës së Lartë, Kolegji thekson se vendime të tilla kanë natyrë të ndërmjetme dhe nuk vendosin për thelbin e të drejtave, për më tepër kur ky vendim, sikurse është cituar më sipër, është i arsyetuar. Nga ana tjetër, pretendimi në lidhje me mosnjoftimin e këtij vendimi nuk rezulton të jetë ngritur për kërkuessin Ilirjan Kavaja, i cili ka marrë njoftimin përkatës nga Gjykata e Lartë, sikurse edhe vendimin e revokimit. Pavarësisht marrjes së njoftimit për vendimin e revokimit, kërkuessi ose përfaqësuesi ligjor i të tre kërkuessve nuk e ka kundërshtuar atë në Gjykatën e Lartë. Po kështu, në bazë të verifikimeve të kryera në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, Kolegji konstaton se kjo e fundit ka shpallur në datën 25.10.2022 listën e çështjeve civile për shqyrtim në dhomën e këshillimit (çështje që kanë revokim) nga Kolegji Civil në datën 10.11.2022, ku përfshihet edhe çështja e kërkuessve. Në këtë kontekst, Kolegji vlerëson se kërkuessit Bardhyl Dervishi dhe Mersin Disha kanë pasur akses për të marrë informacion të mjaftueshëm mbi çështjen, ndërkohë që nga përmbajtja e akteve bashkëlidhur ankimit të tyre nuk rezulton që ata t'i jenë drejtuar Gjykatës së Lartë për të kundërshtuar këtë mënyrë gjykimi. Nga ana tjetër, kërkuessit nuk kanë arritur të provojnë se vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit Civil për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit ka cenuar

parimin e kontradiktoritetit në gjykim ose të drejtën e mbrojtjes, duke mos e ngritur këtë pretendim në nivel kushtetues.

27. Kërkuesit legjitimohen *ratione temporis*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është i datës 10.11.2022, ndërkohë që sipas shkresës nr.1619/1, datë 27.03.2023 të Gjykatës së Lartë, ky vendim është bërë i disponueshëm për palët në datën 26.01.2023 dhe është publikuar në faqen zyrtare të kësaj gjykate në datën 31.01.2023. Ankimi kushtetues është regjistruar në Gjykatë në datën 29.03.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, i cili fillon nga momenti kur ky vendim është bërë i disponueshëm për palët.

28. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të sigurisë juridike dhe standardit të arsytimit të vendimit, pretendime të cilat *prima facie* përfshihen në juridiksionin kushtetues. Duke pasur parasysh thelbin e tyre, Kolegji vlerëson t’i trajtojë në vijim të lidhura së bashku.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsytimit

29. Kërkuesit kanë pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike, pasi në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është mbajtur i njëjti qëndrim sikurse në vendimin e gjykatës së apelit se në rastin konkret gjen zbatim parimi i gjësë së gjykuar. Një konstatim i tillë bie ndesh me nenin 451/a të KPC-së, pasi në vendimin nr. 618, datë 18.06.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, objekt gjykimi ka qenë anulimi i vendimit nr. 1331, datë 20.04.1996 të KKKP-së, Durrës, ndërsa në vendimin nr. (11-2011-2295) 1180, datë 03.05.2011, të po kësaj gjykate, objekti i gjykimit ka qenë konstatimi i pavlefshmërisë absolute të vendimit të sipërcituar. Po kështu, edhe të paditurit nuk kanë qenë të njëjtët në këto gjykime.

30. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës, që sanksionohet në nenin 4 të Kushtetutës. Ajo nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr. 11, datë 21.04.2022; nr. 81, datë 18.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa i përket procesit të rregullt ligjor, siguria juridike është parë nga Gjykata në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, e cila nënkupton që në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që

tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Asnjë gjykatë nuk mundet të gjykojë sërish të njëjtën padi kundrejt të njëjtave palë (*shih vendimet nr. 11, datë 16.04.2018; nr. 71, datë 13.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata ka pohuar se roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 5, datë 01.03.2018; nr. 23, datë 20.04.2016; nr. 3, datë 19.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Sipas Gjykatës, e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimin nr. 41, datë 21.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Kolegji vëren se çështja objekt gjykimi rezulton të jetë gjykuar me vendim të formës së prerë. Vendimi nr. 618, datë 18.06.1999 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë së kërkuësve me objekt anulimin e vendimit të KKKP-së, Durrës dhe ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës me anë të vendimit nr. 509, datë 27.09.1999, duke marrë formë të prerë. Kërkuësit nuk kanë ushtruar rekurs ndaj këtij vendimi. Po kështu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-

2011-2295) 1180, datë 03.05.2011, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së paditësve e të ndërhyrësve kryesorë, duke konstatuar pavlefshmërinë absolute të vendimit nr. 1331, datë 20.04.1996 të KKKP-së, Durrës, duke rrëzuar padinë për kërkimet e tjera. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2014-82/41, datë 16.01.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. (11-2011-2295) 1180, datë 03.05.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke rrëzuar padinë e kërkuësve, me arsyetimin se në gjykimin e kësaj çështjeje gjykata e shkallës së parë ka qenë para “gjësë së gjykuar”, pasi çështja është zgjidhur më parë dhe vendimi nr. 1331, datë 20.04.1996 i KKKP-së, Durrës është gjetur i drejtë dhe i ligjshëm.

35. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, për rekursin e kërkuësve ka arsyetuar se palët nuk mund të përsërisin para gjykatës një pretendim të cilit ajo i është përgjigjur me vendim përfundimtar të formës së prerë. Fuqia e “gjësë së gjykuar” mbulon jo vetëm pjesën urdhëruese të vendimit të formës së prerë, por edhe rrethanat e çështjes të pranuar në gjykim, përfundimet dhe arsyet mbi të cilat është mbështetur pjesa arsyetuese e vendimit dhe që kanë lidhje me atë çka urdhëron gjykata në dispozitivin e tij. Në procesin civil “gjëja e gjykuar” mbulon jo vetëm kërkimet, por edhe prapësimet e parashtruara për të kundërshtuar faktet konstituive të së drejtës së pretenduar nga ana e paditësit apo e kundërpaditësit në gjykim. Njëkohësisht, ky kolegji ka theksuar se për të përcaktuar faktin nëse jemi para të njëjtave palë në një çështje, mbahet parasysh jo vetëm identiteti fizik, por edhe pozita e tyre procedurale. Në rastin konkret, palët në proces janë të njëjta, edhe kur këto palë ndryshojnë pozitën e tyre procedurale. Në këtë rast identiteti i tyre juridik konsiderohet i njëjtë me atë të gjykimit të mëparshëm (*shih vendimin nr. 00-2022-3448, datë 10.11.2022 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, faqet 13 dhe 14, paragrafët 17 dhe 21*).

36. Në kontekst të standardeve të mësipërme kushtetuese, Kolegji çmon se argumentet e parashtruara nga kërkuësit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, në thelb, kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, përkatësisht nenit 451/a të KPC-së. Pretendimeve të tyre u është dhënë përgjigje nga ana e gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë, që kanë kompetencë të vlerësojnë dhe interpretojnë ligjin. Nga ana tjetër, kërkuësit kanë marrë përgjigje nga gjykatat e zakonshme edhe për sa u përket pretendimeve në lidhje me parimin e sigurinë juridike. Interpretimi që gjykatat i kanë bërë këtij parimi nuk rezulton të jetë arbitrar ose në shkelje të së drejtave kushtetuese të kërkuësve. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuësve për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi të pabazuar.

37. Në përfundim, Kolegji vlerëson se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.